

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR

GRAFIK DIZAJN

Kodi: PK-T-1-22

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2022

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“GRAFIK DIZAJN”

(PK-T-1-22)

I. Profili profesional i dizenjuesit grafik

a) Karakteristikat e dizenjuesit grafik

Dizenjuesit grafikë krijojnë prezantime imazhi apo informacioni për media të ndryshme, përfshirë: mediat print, televizion, industri filmike, lojëra kompjuterike, website etj. Përmes njohurive të tyre në fushën e teknologjisë kompjuterike ose artit, ata krijojnë efekte speciale, animime, imazhe të tjera vizuale si dhe prezantime për individë, biznese dhe organizata të ndryshme. Dizenjuesit grafikë kombinojnë aftësitë krijuese me njohjen shumë të mirë të programeve të përparuara kompjuterike për të krijuar produktin që u kërkohet.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e dizenjuesit grafik

Profesioni i dizenjuesit grafik është i lidhur ngushtë me procedurat e punës në lidhje me krijimin e koncepteve vizuale dhe krijimin e dizajneve për reklamim ose informim: si logo, fletëpalosje, kartëvizita, postera, banera, broshura, revista, gazeta, libra, të cilat printohen ose përdoren për publikim digjital. Ai/a jo mund të punësohet në studio grafike si junior designer (2D), ose të punojë si ekspert i pavarur (freelancer). Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e senior designer (2D-3D). Dizenjuesi grafik mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si drejtues dizajneri kreativ.

Përfundimi me sukses i këtij kualifikimi i jep mundësi kursantit të kalojë ose të zhvillohet në profesione të tjera që kanë të bëjnë me dizenjimin grafik si; web dizajn, art dizajn, inxhinieri dizajn etj. Këto kërkojnë përvojë pune, kualifikime të mëtejshme dhe shkollimet përkatëse.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në grupin - njësi të profesioneve “Dizenjues grafik në multimedia”, me kod 2166, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Grafik dizajn”.

Në përfundim të Kursit për “Grafik dizajn”, kursantët do të jenë të aftë të:

- përcaktojnë objektivat e produktit, duke u konsultuar me pritshmërinë e klientëve;
- studiojnë, analizojnë klientin, organizatën dhe produktet e mëparshme të ngjashme të klientit;
- studiojnë, analizojnë produktet e ngjashme në treg për të krijuar një produkt të diferencuar;
- formulojnë konceptet e dizenjimit për produktin që do komunikohet;
- konsultohen për dizenjimin e produktit me analistë biznesi, arkitektë dhe programues softueri;
- përgatitin skica, diagrama dhe modele të ndryshme në print apo kompjuter, për të

- komunikuar konceptet për dizenjimin e produktit;
- dizajnojnë grafikë kompleksë dhe animime, për të kënaqur kërkesat funksionale estetike dhe kreative të modelit që do prezantojnë;
 - përshtatin skicën apo imazhin dixhital me tekstin apo informacionin që produkti duhet të përcjellë;
 - krijojnë imazhe 2D apo 3D, duke vendosur objektin në lëvizje, ose duke ilustruar një proces, duke përdorur programe animimi në kompjuter, print apo modelim;
 - sigurojnë nga klienti ose nga ekspertë të kamerës, materiale filmike me cilësi të lartë HD, në rast prodhim video;
 - transferojnë dokumente audio, video për t'u edituar në mënyrë dixhitale, ose i editojnë vetë, duke përdorur programet të posaçme (Adobe Premiere, Final Cut Pro) etj;
 - krijojnë apo shkruajnë imazhe dhe grafikë shtesë në video, e shndërrojnë apo transferojnë videon në formate të ndryshme për web, mobile, dvd, prezantime etj;
 - regjistrojnë zërin audio në rast reklame, dokumentari, etj dhe përdorin programet përkatëse kompjuterike për pastrimin e zërit;
 - montojnë pamjet video, audio duke përdorur efekte muzikore dhe vizuale;
 - krijojnë punë artistike që përdoret në lojëra kompjuterike;
 - krijojnë sekuenca të animuara duke përdorur programet softuerë;
 - arkivojnë materialet video, audio, apo imazhet dixhitale në një sistem të organizuar dhe ruajtje të të dhënave;
 - zgjedhin, specifikojnë apo rekomandojnë materialet funksionale, estetike dhe mediatike për publikim, shpërndarje apo shfaqje skenike;
 - detajojnë dhe dokumentojnë produktin e dizajnuar të përzgjedhur për prodhim;
 - mbikëqyrin ose ndërmarrin vetë prodhimin e modelit të tij dizajn në mediat e përzgjedhura së bashku me klientin;
 - respektojnë kushtet e kontratës për dorëzimin e produktit cilësor dhe në afat;
 - respektojnë ligjet në fuqi për të drejtën e autorit;
 - rritin profesionalizmin e tyre përmes njohjes së programeve të avancuara kompjuterike, teknikave dizajnuese, e-learning etj.
 - komunikojnë me etikë profesionale.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Grafik dizajn”

Pjesëmarrësit në Kursin për “Grafik dizajn” duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Grafik dizajn”

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Grafik dizajn”

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e dizenjuesit grafik.	MK-26-307-22	30 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të dizenjuesit grafik. 2. Kursanti përcakton elementët e përdorur në dizajn grafik. 3. Kursanti përzgjedh platformat për realizimin e elementëve multimedial në dizajn grafik.
2	Editim imazhesh.	MK-26-308-22	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përcakton elementët e imazhit dhe formatet e tij. 2. Kursanti përcakton hapat e editimit dhe transformimit të imazhit 3. Kursanti ndërton, modifikon dhe retrushon imazhe.
3	Krijimi i ilustrimeve grafike 2D/3D.	MK-26-309-22	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatitet për të dizenjuar në programin e dizenjimit 2D. 2. Kursanti dizenjon logo, kartëvizita dhe fletëpalosje në programin e dizenjimit 2D. 3. Kursanti dizenjon postera, banera dhe broshura në programin e dizenjimit 2D. 4. Kursanti dizenjon ilustrime 3D.
4	Përpunim dhe editim audio/video.	MK-26-310-22	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti planifikon mjedisin e punës për realizimin e një video dhe audio. 2. Kursanti realizon krijimin e një video dhe një audio me teknikat përkatëse. 3. Kursanti realizon përpunimin e audio dhe video me editorët përkatës.
5	Përgatitja e produkteve për printim.	MK-26-311-22	70 orë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit vendin e punës në Adobe Indesign. 2. Kursanti kryen faqosjen e gazetës në Adobe Indesign. 3. Kursanti kryen faqosjen e revistës në Adobe Indesign. 4. Kursanti kryen faqosjen e librit në Adobe Indesign.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Grafik dizajn”.

1. Modul “Hyrje në profesionin e dizenjuesit grafik

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E DIZENJUESIT GRAFIK	MK-26-307-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të dizenjuesit grafik, elementët e përdorur, produktet si dhe platformat e përdorura për krijimin e produkteve.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori; 20% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të dizenjuesit grafik. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të përshkruajë funksionet, detyrat dhe kushtet e punës së dizenjuesit grafik – të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit të punës së dizenjuesit grafik – të përshkruajë kërkesat profesionale të dizenjuesit grafik – të përcaktojë mundësitë e punësimit të dizenjuesit grafik – të rendisë mundësitë e karrierës profesionale të dizenjuesit grafik – të zbatojë legjislacionin në fuqi – të zbatojë rregullat e komunikimit në mënyrë etike me klientët, eprorët dhe kolegët <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim. 	
	<p>RN 2 Kursanti përcakton elementët e përdorur në dizajn grafik. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> – të listojë konceptet kryesore të elementëve multimedial – të përshkruajë elementët multimedial që përdoren në dizajn grafik – të përshkruajë kategoritë e elementëve multimedia (tekst, fotografi, ngjyrat, audio, video, animacion) – të analizojë rëndësinë e përdorimit të elementëve multimedial 	

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursanti përzgjedh platformat për realizimin e elementëve multimedial në dizajn grafik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të listojë llojet e mjeteve të punës për realizimin e një elementi multimedial
- të listojë Softuerët dhe platformat e nevojshme për realizimin e një elementi multimedial
- të përzgjedhë programet e nevojshme për instalim në varësi të llojit të elementit multimedial, që do të realizojë dhe llojit të sistemit operativ ku do të instalohen
- të shkarkojë versionet e fundit të programeve nga faqja zyrtare e tyre
- të ndjekë hapat e instalimit të programeve të nevojshme
- të identifikojë platformat e gatshme në internet të nevojshme për realizimin e elementëve multimedial
- të shpjegojë përdorimet e programeve dhe platformave të përzgjedhura

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinet kompjuterik, ku kompjuterat duhet të jenë të lidhur me internet.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të interpretimit dhe realizimit të koncepteve kryesore në profesionin e dizenjimit grafik.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe elementët multimedial.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe aftësive të fituara që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë:
- Laborator TIK me kompjutera të performancës së lartë.
 - Lidhje në internet
 - Materiale të shkruara në mbështetje të trajtimit të modulit.
-

2. Moduli “Editim imazhesh”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	EDITIM IMAZHESH	MK-26-308-22
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantin për përpunimin, modifikimin dhe ndërtimin e imazheve për editime të imazheve, zmadhime të imazheve, zbatimin e efekteve etj.	
Kohëzgjatja e modulit	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e dizajnerit grafik”	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti përcakton elementet e imazhit dhe formatet e tij <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të shpjegojë dhe të përzgjedhë llojet e imazheve– të shpjegojë dhe të përzgjedhë burimet e imazheve– të shpjegojë dhe të përzgjedhë parametrat kryesore të paraqitjes së imazhit– të shpjegojë dhe të përzgjedhë llojin e grafikës që do realizojë– të shpjegojë dhe të përzgjedhë modelin e ngjyrave– të shpjegojë dhe të përzgjedhë formatin mbi të cilin do punojë imazhet <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgimi me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Kursanti përcakton hapat e editimit dhe transformimit të imazhit <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">– të përcaktojë programin dhe tool-sat me të cilët do të punojë– të instalojë programin ‘Photoshop’ në përshtatje me sistemin e operimit– të përcaktojë komandat për editimin të imazheve në programin ‘Photoshop’– të përcaktojë komandat për transformimin e imazheve në programin ‘Photoshop’– të përcaktojë komandat për retrushimin e imazheve në programin ‘Photoshop’– të përcaktojë ndryshimet e madhësisë dhe rezolucionit gjatë përpunimit të imazhit	

- të përcaktojë ‘Shtresat’ e një punimi
- të përcaktojë vendodhjen e ruajtjes nëpër skedare të punimeve që do kryejë
- të përcaktojë formatin e punës që do kryejë

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndërton, modifikon dhe retushon imazhe

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë imazhet që do të punojë në ‘Photoshop’
- të hapë një dokument të ri me rezolucionin dhe përmasat e nevojshme
- të importojë imazhe në ‘Photoshop’
- të krijojë një panel të personalizuar me ‘tool-sat’ që i nevojiten
- të krijojë shtresat dhe emërtimin e tyre gjatë punës
- të realizojë ndryshimin e dritës, kontrastit dhe balancës së ngjyrës së imazheve
- të përdorë dhe realizojë ‘Maskën’ për shkrirjen e imazheve të ndryshme në një të vetëm (ose shkrirjen e ‘Layers-ave kur është e nevojshme)
- të realizojë ndryshimin e sfondit në një imazh
- të realizojë dublikime, klonime dhe efekte të tekstit në imazhe
- të respektojë standartet e krijimit të imazhit
- të realizojë krijime dhe punime me shtresat për krijimin e nje imazhi te ri
- të realizojë tekstin e kërkuar mbi imazhin e ri të krijuar
- të ruajë imazhin për print ose publikime dixhitale në formatin psd (për banerat) pjeg etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në photoshop, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Atyre duhet ti jepen detyra për editimin dhe transformimin e fotove. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.

-
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, programet, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Kabinet kompjuterik i pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Programet ('*Adobe Photoshop*' dhe variantet e tij) dhe internet.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Krijimi i ilustrimeve grafike 2D/3D”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KRIJIMI I ILUSTRIMEVE GRAFIKE 2D/3D	MK-26-309-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me krijimin e ilustrimeve grafike 2D (logo, kartëvizita, fletëpalosje, kalendare, postera, banera, broshura etj) dhe 3D duke respektuar teknikat dhe parimet e dizenjimit.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e dizajnerit grafik”	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti parapërgatitet për të dizenuar në programin e dizenjimit 2D. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë programin e dizenjimit të ilustrimeve 2D (Illustrator, Coreldraw, Vectr, Inkscape etj)– të instalojë programin e dizenjimit 2D– të përkrahë mjedisin e punës në programin e dizenjimit 2D– të shpjegojë përdorimin e mjeteve dhe veglave bazike për të dizenuar logo, fletëpalosje, kartëvizita, kalendare, postera, banera, broshura– të shpjegojë formatet dhe njësitë matëse për të dizenuar logo, fletëpalosje, kartëvizita, kalendare, postera, banera, broshura– të përdorë terminologjinë e duhur për principet dhe elementet e dizajnit për krijimin e produkteve <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgimi me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Kursanti dizenuon logo, kartëvizita dhe fletëpalosje në programin e dizenjimit 2D. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">– të përshkruajë llojet dhe veçoritë e logove, kartëvizitave dhe fletëpalosjeve– të bëjë kërkime në internet rreth logove, kartëvizitave dhe fletëpalosjeve që do të dizenuojë– të bëjë analizë rreth logove, kartëvizitave dhe fletëpalosjeve që do të dizenuojë– të përpunojë dhe pozicionojë logon, kartëvizitën dhe fletëpalosjen në mënyrë të saktë, në programin e	

- dizenjimit 2D
- të përdorë mjetet për shkrimin e ngjyrave gjatë dizenjimit të logos, kartëvizitës dhe fletëpalosjes në programin e dizenjimit 2D
- të aplikojë lloje të ndryshme fontesh për krijimin e logos, kartëvizitës dhe fletëpalosjes në programin e dizenjimit 2D
- të bëjë strukturimin, modifikimin e logos, kartëvizitës dhe fletëpalosjes në programin e dizenjimit 2D
- të rishikojë logon, kartëvizitën dhe fletëpalosjen para se të publikohet ose të printohet
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të logos, para se të publikohet ose të printohet
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet logo, kartëvizita dhe fletëpalosja (tekstil, plastik, letër adeziv, qelq, qeramik etj)
- të aplikojë mockup-e në objekte të ndryshme
- të përshtasë logot, kartëvizitën dhe fletëpalosjen sipas kërkesës së klientit
- të respektojë standartet për krijimin e logove, kartëvizitave dhe fletëpalosjeve
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer
- të komunikojnë në mënyrë korrekte dhe prezantojnë dizajnin klientit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti dizenjon postera, banera dhe broshura në programin e dizenjimit 2D.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë llojet dhe veçoritë e posterave, banerave dhe broshurave
- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të banerave, posterave dhe broshurave
- të bëjë kërkime në internet rreth banerave, posterave dhe broshurave që do të dizenjojnë
- të bëjë analizë rreth banerave, posterave dhe broshurave që do të dizenjojnë
- të përdorë mjetet dhe veglat e punës për dizenjimin e banerit dhe posterit në programin e dizenjimit 2D
- të pozicionojë shtresat (layerat) e punimit në mënyrë të saktë, në programin e dizenjimit 2D
- të përdorë mjetet për shkrimin e ngjyrave gjatë dizenjimit të banerit dhe posterit, në programin e dizenjimit 2D
- të aplikojë lloje të ndryshme fontesh për dizenjimin e banerit dhe posterit, në programin e dizenjimit 2D
- të bëjë strukturimin, modifikimin e banerit dhe posterit, në programin e dizenjimit 2D

- të rishikojë banerin dhe posterin përpara se të printohet ose publikohet
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të banerit dhe posterit, para se të publikohet ose të printohet
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet baneri (plastik, leter, adeziv etj)
- të përshtatë banerin dhe posterin sipas kërkesës së klientit
- të aplikojë dizajnin mockup-e në objekte të ndryshme
- të respektojë standartet për krijimin e banerit dhe posterit
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe prezantojë dizajnin klientit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti dizajon ilustrime 3D

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë programin e dizenjimit 3D (Blender etj)
- të instalojë programin e dizenjimit 3D
- të konfigurujë dritaren e punës në programin e përzgjedhur
- të përzgjedhë llojin e dizenjimit 3D
- të përshkruajnë komandat në programin 3D për realizimin e një dizenjimi të thjeshtë 3D
- të listojnë hapat standarte të realizimit të dizenjimit 3D
- të listojë elementët e dizenjimit 3D
- të përzgjedhë llojin e dizenjimit 3D
- të zbatojë teknikat e dizenjimit 3D
- të përcaktojë hapat e punës për realizimin e dizenjimit
- të zbatojë teknikat e dizenjimit 3D në programin e zgjedhur
- të përshkruajë rezultatet e pritshme të projektit
- të përshkruajë metodikat e vizatimit dhe skicimit të idesë
- të vizatojë/skicojë një model paraprak të skenarit të dizenjimit 3D
- të paraqesë një prezantim të modelit paraprak të dizenjimit 3D
- të menaxhojë në mënyrë dinamike punën në raport me kohën dhe objektivat

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në ilustrator, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Atyre duhet ti jepen detyra për të dizenuar logo, kartëvizita, fletëpalosje, kalendare, postera, banera, broshura etj. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me projektet që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës.
 - Kompjuter, programe, internet.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Programe të dizenjimit 2D dhe 3D (të paketës *Adobe* ose të tjera të ngjashme pa pagesë).
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Përpunim dhe editim audio/video”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRPUNIM DHE EDITIM AUDIO/VIDEO	MK-26-310-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të realizuar e përpunuar një video/audio.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e dizenjuesit grafik”.	
Rezultatet e të Nxënërit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti planifikon mjedisin e punës për realizimin e një video dhe audio. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të mbledhë informacion mbi programet e ndryshme për realizimin e një video apo audio– të analizojë programet dhe platformat që nevojiten për realizimin e video-ve dhe audio-ve– të përzgjedhë programet dhe platformat e duhura për realizimin e video-ve dhe audio-ve– të zgjedhë elementët e duhur grafik që do të përmbajë video (tekst, ngjyra, imazhe, audio, video, animacion)– të përcaktojë formatin e audios sipas standarteve– të përcaktojë formatin e videos sipas standarteve– të përcaktojë kohëzgjatjen e video dhe audio– të listojë mjetet që nevojiten për realizimin e video-ve dhe audio-ve (mikrofon, kamera, mikser, kompjuter etj)– të kontrollojë mjetet e nevojshme të punës mbi funksionimin e tyre– të konceptojë përmbajtjen e video apo audio– të prezantojë idenë e projektit <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgimi me listë kontrolli.	
	<p>RN 2 Kursanti realizon krijimin e një video dhe një audio me teknikat përkatëse. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">– të planifikojë radhën e punës për realizimin e videos dhe audios– të zgjedhë programet e montazhit që nevojiten për instalim në përputhje me parametrat e kompjuterit	

- të shkarkojë programin e duhur nga interneti
- të ndjekë hapat e instalimit të programeve të nevojshme
- të përcaktojë saktë formatet që do përdore për videon dhe audion
- të sigurojnë nga ekspertë të kamerës materiale filmike me cilësi të lartë
- të regjistrojë audion në kompjuter
- të importojë filet audio dhe video për t'u edituar në programet përkatëse
- të realizojë digjitalizimin e videos dhe audio-s
- të përcaktojë madhësinë e videos duke marrë parasysh (frame rate), (frame size), (color depth)
- të realizojë integrimin e elementëve të videos dhe audios në produktin final
- të eksportojë videon dhe audion në versione të ndryshme (web, mobile, dvd etj...)

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti realizon përpunimin e audio dhe video me editorët përkatës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë programe dhe tools-e të ndryshme softuerike si editorë audio (Adobe Audition, Free Audio Editor, Easy Ringtone Editor etj...) për përpunimin e audio-ve
- të përshkruajë hapat e përpunimit të audios
- të realizojë ngarkimin e audio-s në editorë
- të realizojë prerjen e audios (heqjen e hapësirës boshe në fillim, fund ose në mes të audio-s)
- të realizojë reduktimin e zhurmës në audio
- të realizojë modifikimin dhe lidhjen me një audio tjetër
- të realizojë balancimin e tonit duke rregulluar nivelin e zërit të audio
- të realizojë vendosjen e efektit të zërit në fillim dhe fund të audios (fade-in, fade-out)
- të realizojë shtrirjen e kohës së audios si dhe invertimin e zërit duke i dhënë audios efekte surreale
- të integrojë efekte speciale mbi një audio si (Jehona (Echo), Reverberimi (Reverb), Chorus (kori), Acoustic Mirror, etj)
- të realizojë arkivimin e materialeve duke eksportuar audion në dosjen e duhur
- të përzgjedhë programe dhe tools-e të ndryshme softuerike për përpunimin e video-ve si (Adobe Premiere, Final Cut Pro, Microsoft Movie Maker, etj.
- të përshkruajë hapat e përpunimit të video-s
- të realizojë montimin e inserteve të video-s

- të realizojë editimin e imazheve si korigjimi i ngjyrës, ndriçimit, aplikimi i filtrave special
- të realizojë shtimin e tekstit në video
- të realizojë vendosjen e efektit video-transition për kalimin nga një plan në një tjetër në imazhe, video dhe animacione
- të realizojë integrimin e audios në video
- të krijojë logo sigurie digjitale mbi audion dhe videon e krijuar për të mbrojtur të drejtat e autorit
- të realizojë arkivimin e materialeve duke eksportuar video-n në dosjen e duhur
- të zbatojë politikat e sigurisë në përdorimin e harduerë, softuerë dhe të dhënat sipas legjislacionit përkatës

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në laboratorin e praktikës së kompjuterave.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për realizimin e një ose disa llojeve të video dhe audio.
- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për realizimin e një audio/video të caktuar, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Instruktori i praktikës duhet të nxitë kursantët të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të tyre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Laborator TIK me kompjutera të performancës së lartë.
 - Lidhje në internet.
 - Programet e nevojshme për realizimin e audio-ve dhe video-ve.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të trajtimit të modulit.
-

5. Moduli “Përgatitja e produkteve për printim”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E PRODUKTEVE PËR PRINTIM.	MK-26-311-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe përdorimin e mjeteve të punës në Adobe Indesign ose në programe të ngjashme dhe i aftëson ata të përgatisin produkte të ndryshme për printim.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e dizenjuesit grafik”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti parapërgatit vendin e punës në Adobe Indesign Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të përzgjedhë programin që do të përdorë (Adobe Indesign ose edhe programe të tjera të ngjashme)– të instalojë programin Adobe Indesign– të pëshkruajë mjedisin e punës në Adobe Indesign– të përshkruajë rregullat teknike të dizenjimit në Adobe Indesign– të pëshkruajë parimet e dizenjimit në Adobe Indesign– të shpjegojë përdorimin e mjeteve dhe veglave të punës në Adobe Indesign– të përshkruajë përdorimin e paletave– të shpjegojë veprimet bazë në përpunimin e tekstit– të shpjegojë veprimet bazë në punimet me paragrafet e tekstit– të përshkruajë stilet e veçanta të paragrafeve dhe objekteve– të përshkruajë shtresat e një punimi (layerat)– të shpjegojë veprimet bazë në manipulimin e ngjyrave– të përshkruajë objektet që dizenjohen në Adobe Indesign <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgimi me listë kontrolli. <p>RN 2 Kursanti kryen faqosjen e gazetës në Adobe Indesign. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">– të bëjë kërkime në internet rreth gazetave që do të dizenjojë– të bëjë analizë rreth gazetës që do të dizenjojë– të krijojë një publikim të ri– të hapë dokumentat e dhura për dizenjimin e gazetës– të përdorë kutinë e mjeteve të punës	

- të përdorë paletat e kontrollit
- të përdorë guidat e vizoreve të anëve dhe kolonave
- të bëjë zmadhimin dhe zvogëlimin e figurës
- të bëjë zhvendosjen e figurës
- të përdorë të gjitha komandat e duhura për formatimin e tekstit
- të kryejë veprimet bazë në përpunimin dhe strukturimin e tekstit
- të përdorë stilet e veçanta të paragrafeve dhe objekteve
- të vendosë imazhe në objekte
- të kryejë veprime të tjera të menaxhimit të shtresave (ndryshimi i radhës së mbivendosjes, grupimi, radhitja dhe shpërndarja e objekteve)
- të punojë me ngjyrat në Indesign për dizenjimin e gazetës
- të punojë me faqet Master
- të bëjë strukturimin përfundimtar të faqes në Indesign
- të vendosë numrin e faqeve dhe përmbajtjen e gazetës me anë të faqeve Master
- të rishikojë gazetën para se të printohet
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të gazetës para se të printohet
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet gazeta (letër, etj.)
- të përshtatë gazetën sipas kërkesës së klientit
- të respektojë standartet për dizenjimin e gazetës
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe prezantojë dizajnin klientit
- të ruajë dokumentin në Indesign

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti kryen faqosjen e revistës në Adobe Indesign.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë llojet dhe veçoritë e revistave
- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të revistave
- të bëjë kërkime në internet rreth revistës që do të dizenjojë
- të bëjë analizë rreth revistës që do të dizenjojë
- të krijojë një publikim të ri
- të hapë dokumentat e duhura për dizenjimin e revistës
- të përdorë kutinë e mjeteve të punës për zhvillimin e revistës, në Indesign
- të përdorë paletat e kontrollit për zhvillimin e revistës, në Indesign
- të menaxhojë paletat e kontrollit gjatë zhvillimit të revistës, në Indesign

- të përdorë guidat e vizoreve për zhvillimin e revistës në Indesign
- të përdorë guidat e anëve dhe kolonave për zhvillimin e revistës në Indesign
- të bëjë zmadhimin dhe zvogëlimin e figurës për zhvillimin e revistës në Indesign
- të bëjë zhvendosjen e figurës për zhvillimin e revistës në Indesign
- të anulojë veprimet kur është e nevojshme për zhvillimin e revistës në Indesign
- të përdorë të gjitha komandat e duhura për formatimin e tekstit për zhvillimin e revistës në Indesign
- të kryejë veprimet bazë në përpunimin e tekstit për zhvillimin e revistës në Indesign
- të strukturojë paragrafet e tekstit për zhvillimin e revistës në Indesign
- të vendosë imazhe në objekte për zhvillimin e revistës në Indesign
- të kryejë veprime të tjera të menaxhimit të objekteve (ndryshimi i radhës së mbivendosjes, grupimi, radhitja dhe shpërndarja e objekteve)
- të punojë me ngjyrat në Indesign për dizajnimin e gazetës (përdorimi i paletës Swatches (mostrat), përdorimi i paletës së ngjyrave, përdorimi i katalogëve të ngjyrave të gatshme, krijimi dhe aplikimi i gradiencave)
- të kryejë strukturimin përfundimtar të faqes në Indesign
- të vendosë numrin e faqeve dhe përmbajtjen e revistës me anë të faqeve Master
- të rishikojë dhe të bëjë korrigjimet e duhura të revistës para se të printohet
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të revistës para se të printohet
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet revista (letër etj.)
- të përshtasë revistën sipas kërkesës së klientit
- të respektojë standartet për dizajnimin e revistës
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe prezantojë dizajnin klientit
- të ruajë dokumentin në Indesign

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti kryen faqosjen e librit në Adobe Indesign.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë llojet dhe veçoritë e librave
- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të librave

- të bëjë kërkime në internet rreth librit që do të dizenojë
- të bëjë analizë rreth librit që do të dizenojë
- të krijojë një publikim të ri
- të hapë dokumentat e dhura për dizejimin e librit
- të përdorë kutinë e mjeteve të punës për zhvillimin e librit në Indesign
- të përdorë paletat e kontrollit për zhvillimin e librit në Indesign
- të menaxhojë paletat e kontrollit gjatë zhvillimit të librit në Indesign
- të përdorë guidat e vizoreve për zhvillimin e librit në Indesign
- të përdorë guidat e anëve dhe kolonave për zhvillimin e librit në Indesign
- të kryejë zmadhimin dhe zvogëlimin e figurave për zhvillimin e librit në Indesign
- të kryejë zhvendosjen e figurave për zhvillimin e revistës në Indesign
- të anulojë veprimet kur është e nevojshme për zhvillimin e librit në Indesign
- të përdorë të gjitha komandat e dhura për formatimin e tekstit për zhvillimin e librit në Indesign
- të kryejë veprimet bazë për krijimin dhe përpunimin e tekstit për zhvillimin e librit në Indesign
- të importojë tekstin në *Indesign* nga *Word*-i
- të strukturojë paragrafet e tekstit për zhvillimin e librit në Indesign
- të vendosë imazhe në objekte për zhvillimin e librit në Indesign
- të përdorë stilet e veçanta të paragrafeve dhe objekteve
- të kryejë veprime të tjera të menaxhimit shtresave (ndryshimi i radhës së mbivendosjes, grupimi, radhitja dhe shpërndarja e objekteve)
- të punojë me ngjyrat në Indesign për dizejimin e librit (përdorimi i paletës Swatches (mostrat), përdorimi i paletës së ngjyrave, përdorimi i katalogëve të ngjyrave të gatshme, krijimi dhe aplikimi i gradiencave)
- të vendosë përmbajtjen e librit dhe numrin e faqeve me anë të faqeve Master (master page)
- të bëjë strukturimin përfundimtar të faqes në Indesign
- të rishikojë librin para se të printohet
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të gazetës para se të printohet ose publikim dixhital
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet libri (letër, etj.)
- të përshtasë librin sipas kërkesës së klientit
- të respektojë standartet për dizejimin e librit
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer

- të prezantojë në mënyrë korrekte dizajnin klientit
- të komunikojë në mënyrë korrekte me klientin
- të ruajë dokumentin (librin) në Indesign

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në Indesign, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Atyre duhet ti jepen detyra për të dizenuar gazeta, revista dhe libra. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me projektet që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës.
 - Kompjuter, programe.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-